

Nëse është e nevojshme ju keni të drejtën të përdorni shërbimet e një përkthyesi. Lutemi na informoni për kërkesat për një përkthyes kur caktoni vizitën tuaj. Personeli i kujdesit ndaj shëndetit do të organizojë një përkthyes nga një agjenci përkthimi.

## **Nëse nuk jeni të kënaqur me kujdesin shëndetësor**

Ne duam që ju të merrni kujdes shëndetësor të shkëlqyer dhe të mbeteni të kënaqur. Ndaj është shumë e rëndësishme që ju të na thoni se çfarë mendoni se është pozitive dhe se çfarë duhet përmirësuar.

### **Flisni me personelin**

Filloni duke folur me personelin që kujdeset për ju ose duke folur me menaxherin përkatës.

### **Këshilla dhe ndihmë nga Komiteti i Këshillimit të Pacientëve**

Nëse problemi nuk mund të zgjidhet, ju ose dikush tjetër në emër tuaj mund të kontaktojë punonjësën e Komitetit të Këshillimit të Pacientëve. Komiteti i Këshillimit të Pacientëve ndihmon dhe mbështet individët të cilët kanë pikëpamje dhe opinione rreth kujdesit shëndetësor brenda Bashkisë së Rrethit (përfshi Shërbimin Publik Dentar të Suedisë) dhe bashkitë.

Komiteti i Këshillimit të Pacientëve është plotësisht i fshehtë.

Komiteti i Këshillimit të Pacientëve në përputhje me ligjin

- Do të promovojë kontakte ndërmjet pacientëve dhe personelit të kujdesit të shëndetit
- Do t'u ofrojë pacientëve dhe të afërmeve të tyre informacionin që ju nevojitet në lidhje me atë çka ju nevojitet për kujdesin shëndetësor
- Do të vëmë në kontakt pacientët me autoritetin e duhur
- Do të përmirësojë shërbimet e kujdesit shëndetësor duke raportuar tek autoritete të ndryshme ankesat, kritikën dhe sugjerimet nga qytetarët.

### **Bërja e një raporti tek Bordi Kombëtar i Shëndetit dhe Mirëqenies**

Ju mund të bëni një raport tek Bordi Kombëtar i Shëndetit dhe Mirëqenies Detyra e tyre është të shqyrtojnë ankesat rreth kujdesit shëndetësor dhe mjekësor, kujdesit dentar dhe personelit që punon në këtë fushë. Për të paraqitur një raport ju nuk keni nevojë të thoni as të dini emrin e personit që ka bërë gabimin ose se çfarë e ka shkaktuar lëndimin. Bordi Kombëtar i Shëndetit dhe Mirëqenies mund të hetojë të tërë ngjarjen dhe jo vetëm veprimet e një personi të veçantë. Fokusi i hetimit është të gjejë shkakun e problemit dhe se çfarë duhet bërë në mënyrë që të mos ndodhë sërish. Në këtë mënyrë kujdesi mjekësor do të bëhet më i sigurt. Nëse doni të informoheni më tej rreth kësaj gjëje lutemi kontaktoni Punonjësën e Bordit për Pacientët.

### **Informacioni i kontaktit**

Socialstyrelsen

Enskildas klagomål

106 30 Stockholm

Adresa e internetit [www.socialstyrelsen.se/klagapavarden](http://www.socialstyrelsen.se/klagapavarden)

Vini re se raporti juaj do të bëhet pronë publike dhe do t'i ofrohet publikut sipas kërkesave.

### **Sigurimi i pacientëve**

Sigurimi i pacientëve shpesh mbulon lëndimet e shkaktuara nga trajtimet e bëra nga spitali, klinikat e doktorëve ose klinikat dentare. Kjo do të thotë se ju keni të drejtën të kompensoheni pas ekzaminimit të raportit. Raportimi duhet bërë brenda një periudhe tre vjeçare. Nëse dëshironi më shumë informacion kontaktoni punonjës in e Komitetit Këshillimor për Pacientët.

### **Informacioni i kontaktit:**

Landstingens Ömsesidiga Försäkringsbolag

Box 178 30, 118 94 Stockholm

Tel 08 551 010 00

Adresa e internetit [www.patientforsakring.se](http://www.patientforsakring.se)

### **Sigurimi farmaceutik**

Nëse pësoni lëndim të shkaktuara nga përdorimi i barnave të shitura në Suedi ju mund ta raportoni këtë tek Siguruesi Farmaceutik. Vini re se nuk keni të drejtën e kompensimit për efekte anësore ose për lëndime të shkaktuara nga keqpërdorimi i barnave. Lëndimet duhen raportuar jo më vonë se tre vjet pas incidentit.

### **Informacioni i kontaktit:**

Läkemedelsförsäkringen

Försäkringsbolaget Zürich

Box 5069

102 42 Stockholm

Tel 08 57 93 30 00

Adresa e internetit: [www.lakemedelsforsakringen.se](http://www.lakemedelsforsakringen.se)

### **Jeni të interesuar të bëheni këshilltar?**

Komiteti i Këshillimit të Pacientëve është përgjegjës për zgjedhjen e individëve që ndihmojnë në emër të pacientëve me aftësi të kufizuara përcaktuar nga ligji. Të qenurit një person që ndihmon do të thotë se ju ndihmoni pacientët me çështje personale në fshehtësi të plotë dhe mbani kontakte me Komitetin Këshillimor të Pacientëve. Individët që ndihmojnë marrin si trajnim ashtu dhe asistencë dhe marrin edhe një lloj kompensimi financiar. Nëse jeni të interesuar kontaktoni punonjës in e Komitetit Këshillimor të Pacientëve.

### **Kontakttoni punonjës in e Komitetit të Pacientëve në Bashkinë e Rrethit Kronoberg**

Telefoni 0470-58 85 42, posta elektronike: [patientnamnden@ltkronoberg.se](mailto:patientnamnden@ltkronoberg.se)